

Republika e Serbisë
Ministria e Punëve të Brendshme
shpall

KONKURS
PËR PRANIMIN E 480 KANDIDATËVE NË QENDRËN PËR TRAJNIM
THEMELOR POLICOR

Ministria e Punëve të Brendshme do të regjistroj në Qendrën për Trajnim Themelor Policor 480 kandidat për trajnim profesional për kryerjen e punëve policore, edhe atë: 210 kandidat për zonën e Administratës Policore për qytetin e Beogradit, 30 kandidat për zonën e Administratës Policore në Bor, 40 kandidat për zonën Administratës Policore në Valevë, 20 kandidat për zonën e Administratës Policore në Vranjë, 60 kandidat për zonën e Administratës Policore në Kikind, 30 kandidatë për zonën e Administratës Policore në Pozharevcë, 30 kandidat për zonën e Administratës Policore në Kamenicë të Sremit, 30 kandidat për zonën e Administratës Policore në Subotic dhe 30 kandidat për zonën e Administratës Policore në Uzhicë.

Trajnimi profesional i kandidatëve do të zgjat 12 muaj.

KUSHTET E KONKURSIT

Të drejtë për të aplikuar ka personi i cili përveç kushteve të përgjithshme për t`u pranuar në mardhënie pune në organin shtetëror, duhet t`i plotësoj edhe disa kushte të veçanta, të cilat janë:

1. të jetë shtetas i Republikës së Serbisë;
2. që sëpaku të ketë një vit vendbanim në territorin e administratës policore për të cilën konkuron;
3. të mos ketë më pak se 18 dhe më shumë se 26 vjet;
4. të ketë të përfunduar shkollën e mesme;
5. të mos egzistojn pengesa të sigurisë për prani në mardhënie pune në Ministri;
6. të i plotësoj kushtet e veçanta në aspektin shëndetësor, psikologjik, statusin bazë – motorik dhe disa aftësi tjera të veçanta për kryerjen e punëve policore.

Të drejtë për aplikim në konkurs ka personi i cili nuk e kryer shërbimin ushtarak, si dhe personi i cili ka kryer shërbimin ushtarak me armë.

Të drejtën për aplikim në konkurs e ka edhe personi i cili nuk e ka dhënë provimin për vozitje të kategorisë „B“, me një kusht për të kaluar atë mbrenda afatit tri vjeçar nga shpallja e konkursit.

Konkursin e zbaton komisioni të cilin e emëron ministri i punëve të mbrendshme.

MËNYRA E KONKURIMIT

Aplikimi në konkurs me dokumentacionin e nevojshëm duhet të dorëzohet në afat prej 15 ditëve nga dita e shpalljes së konkursit, në stacionet policore sipas vendbanimit të kandidatit.

DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM

Aplikimi (formulari i cili mund të merret në stacionet policore);

dokumentet origjinale:

- çertifikata e shtetësisë (të mos jetë më e vjetër se gjashtë muaj);
- çertifikata e lindjes;
- vërtetimin se ndaj kandidatit nuk udhëhiqet procedur penale;
- diplomën e përfundimit të shkollës së mesme;
- çertifikatën nga të dhënat mjekësore të mjekut ordinar, në formularin i cili merret në stacionin policor;
- vërtetimin rreth kryerjes së shërbimit ushtarak.

kopjet e vërtetuara:

- deftesat për të gjitha vitet e shkollës së mesme;
- letërnjoftimi;
- lejën e vozitjes të kategoris “B”, nëse e ka të kaluar provimin për vozitje.

PROCEDURA PËR KANDIDATËT E PARAQITUR

Procedura zgjat një deri tri ditë, varësisht nga rezultatet e arritura gjatë ditës së parë, përkatësisht ditës së dytë.

Kontrollimi mjekësor për përcaktimin e gjendjes shëndetësore të kandidatit, përbëhet nga kontrollimi mjekësor i përgjithshëm, kontrollimi specialistik dhe testi i drogës, të cilën e kryen Instituti për mbrojtje shëndetësore të punëtorëve i Ministrisë në përputhshmëri me kriteret e përcaktuara.

Kontrollimi i përgjithshëm mjekësor është eliminues në aspektin e aderimit në kontrollet specialistike.

Kandidatët janë të detyruar t'ua kalojnë provimin kualifikues i cili përbëhet nga aftësitë gjuhësore, kulturore edhe drejtshkrimore, nga verifikimi psikologjik dhe statusit bazë – motorik si dhe intervista.

Çdo verifikim individual është eliminues për kandidatët të cilët nuk plotësojnë normat e përcaktuara.

Me rastin e verifikimit, kandidatët shënohen me shifra, çka siguron barazi të plotë të kandidatëve në procesin e përzgjedhjes.

Kandidatët të cilët kanë plotësuar kushtet e veçanta dhe kanë kaluar provimin kualifikues për regjistrim në Qendër, rangohen në bazë të rezultatit të arritur në të gjitha katër segmentet e provimit kualifikues.

Pas përfundimit të procedurës me kandidatët e paraqitur, Komisioni përcakton rang listën përfundimtare të kandidatëve.

Në bazë të rang listës përfundimtare, vendimin për pranimin e kandidatëve për trajnimin themelor policor e sjell ministri.

Kandidati i cili nuk pranohet do të njoftohet me shkrim në afat prej tetë ditëve nga dita e marrjes së vendimit.

Ndaj vendimit, kandidati mund parashtroj ankesë ministrit, përmes Qendrës, në afat prej tetë ditëve nga dita e marrjes së njoftimit.

Me nënshkrimin e kontratës rreth të drejtave dhe detyrimeve reciproke në mes kandidatëve të trajnimit themelor policor dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme, kandidati i fiton statusin e kandidatit të trajnimit themelor policor. Kontrata nënshkruhet në afat prej më pak se pesë ditë nga dita e fillimit të trajnimit.

Njoftimi i kandidatëve rreth pranimit në trajnim, rreth vendit dhe kohës së nënshkrimit të kontratës për rregullimin e drejtave dhe detyrimeve reciproke në mes kandidatit dhe Ministrisë, shpallet më së paku dhjetë ditë para fillimit të trajnimit.

Në vend të kandidatit i cili nuk e nënshkruan kontratën në afatin e përcaktuar, ftohet tjetri kandidat sipas rradhës në rang listën përfundimtare.

Kandidati i cili nuk i plotëson kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara në konkurs për pranim ose nuk kalon provimin kualifikues, përmes njoftimit me shkrim, në adresën e shtëpisë, i kthehet edhe dokumentacioni i bashkangjitur me paraqitjen në konkurs.

Kandidatët e ftuar në provimin pranues mbartin shpenzimet e rrugës, shpenzimet e qëndrimit dhe shpenzimet e kontrollit mjekësor.

Rreth kohës së mbajtjes të provimit pranues kandidatët do të njoftohen me kohë.

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E KANDIDATËVE PËR TRAJNIMIN THEMELOR POLICOR

Kandidati i cili me sukses kryen trajnimin themelor policor do të merr çertifikatë dhe do të arrin mundësin e fitimit të mardhënies së punës në përputhshmëri me ligjin, me Ministrinë e Punëve të Brendshme, si praktikant për zyrtar policor në administratën policore për të cilën ka konkuruar.

Gjithashtu detyrohet që pas arritjes së mardhënies të punës, duhet të qëndroj në punë së paku tri vite në administratën policore.

Kandidatët e pranuar gjatë trajnimit themelor policor e kanë të siguar akomodimin dhe ushqimin, si dhe paisjet e nevojshme për realizimin e përmbajtjes mësimore, sipas kontratës të cilën kandidati e arrin me Ministrinë e Punëve të Brendshme.

ADRESA E QENDRËS:

Qendra për trajnim themelor policor
Sremska Kamenica, rruga Zhelleznička 22
tel: **021/462-033; 462-539**
www.copo.edu.rs
office@copo.edu.rs